



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1206/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Asllan Kruezi, kryetar i PAI-së në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Asllan Kruezi kryetar i Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) në Ferizaj

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:15 nga Asllan Kruezi kryetar i PAI-së në Ferizaj duke pretenduar se nuk i pranon rezultatet e shpallura nga KQZ-ja pasi që votat e PAI-së janë bartuar tek subjekti PDAK thuhet në pretendimet e ankuesit. Ankuesi kërkon rinumërimin e të gjitha votave në komunën e Ferizajt.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kryetarit të PAI-të Asllan Kruezi, shqyrtoi dokumentet e bashkangjitura si prove dhe konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi bindëse. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 1206/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.